



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agri Bau Sh.P.K." të datës 17.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender LOT 1" me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agri Bau Sh.P.K." të datës 17.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender LOT 1" me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Agri Bau Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 17.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender LOT 1" me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

## Pretendimet ankimore të parashtruesit:

### Pretendimi 1.

Pas vendimit të OSHP-së me nr 2025/0020 i dt 01.04.2025 (mbi aprovimin e ankesës tone), ju si AK duke u bazuar në këtë vendim me date 23.05.2025 keni dërguar dokumentin B47 letër standarde për sqarime tenderi, ku keni kërkuar sqarime lidhur me marrëveshjet për korpa ngritëse në mes kompanisë tone Agribau SHPK dhe kompanive; ANFA GROUP SHPK, BLINI CLEANERS SHPK me pyetjen e vetme të juaj si më poshtë:

Kjo kontratë –Marrëveshje është e pa qarte sepse kërkesë AK se ka qenë që OE të ofroje dëshmi dokumentare;

Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre.

1. Pyetja jone është a keni pasur Marrëveshje për shfrytëzimin pajisjeve me qira me Operatorët e lartë shënuar ekonomik, apo Kontratë për kryerjen e shërbimeve për nevojat e "Agrui Bau" ?

Prandaj, bazuar në kërkesën e juaj se kontratat janë të pa qarta dhe nevojitet sqarime lidhur me këtë kontratë, ne si Agribau ju kemi dhënë sqarimin dhe përgjigjeja jone në pyetjen e juaj është kthyer me datë 27.05.2025 ku kemi sqaruar lidhur me kontratat e lartcekura (shih me posht pjesën përfundimtare të përgjigjes tone si rikapitullim i përgjigjes).

*Pra si rikapitullim i kësaj sqarimi.*

1. Marrëveshjet me kompanitë Blini Cleaners SHPK dhe Anfa Group SHPK janë marrëveshje për shfrytëzim të shportave ngritëse me qira me qmën 20.00 euro për Oraqume, dhe janë në përputhje të plote me kërkesën e juaj të FTD.
2. Shporta ngritëse e vendosur në Kamionin me targë 01-790-ZS ku shkruan kamion me vinq, është në përputhje të plote me kërkesën e juaj të FTD.

*Prandaj sipas sqarimit të lartcekur ne kemi dorëzuar në ofertën tone 3 pajisje-shporta ngritëse në përputhje të plote me kërkesën e juaj të FTD.*

Ma gjerësisht mund të referoheni pyetjes së datës 23.05.2025 dhe përgjigjes të dhënë nga ana jonë me datë 27.05.2025 të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit të cilat nuk i ngarkum në tersi por vetëm thelbin e përmbajtjes së pyetjes dhe përgjigjes rreth marrëveshjeve për korpat ngritëse.

Po ashtu përveq përgjigjes në sqarime tenderi date 27.05.2025 lidhur me kontratën me Blini Cleaners, ne si Agribau në kërkesën për Rishqyrtim të datës 16.06.2025 ju kemi dërguar edhe vazhdimin e Kontratë-Marrëveshjet me Qira për shportën ngritëse me kompaninë Blini Cleaners SHPK, e cila ka patur afat 3 vjeçar deri me datë 01.06.2025, dhe me rastin e rivlerësimit ju keni pasur kontratën e vazhduar edhe për 3 vitet e ardhshme nga 01.06.2025 deri me datë 31.05.2028, në të cilën është e precizuar dhe sqaruar se kjo kontratë-Marrëveshje ka të bëjë me shfrytëzim të pajisjes me Qira për 3 vite e ardhshme.

Pasi që ju në vendimin e datës 09.06.2025 keni pretenduar lidhur me **Regjistrim valid të pajisjeve** ashtu siq e keni cekur ju në vendim, në kësaj kërkesë i bashkangjesim edhe certifikatat e regjistrimit valide të pajisjeve.

Prandaj ky vendim per eliminim te kompanise tone eshte ne kundërshtim me ligjin mbi Prokurimin publik pikerisht me nen-in 59-Egzaminimi, Vlersimi dhe Krahësimi i Tenderëve, si dhe nenin 72 te LPP-se edhe nderlidhen dhe bin ne kundërshtim me te gjitha dispozitat e theksuara ma lart .

Provë:

**Letrat standarde e dates 23.05.2025 dhe**

**Letra standarde Pergjigjeja nga ana jone me date 27.05.2025**

**Kontrata e vazhduar e marrjes me qera per shportën ngritëse me "Blini Cleaners SHPK".**  
**Certifikatat e regjistrimit te pajisjeve (librezat e kamionave).**

**Sqarim ma konkret:**

Ne si ofertues i kemi plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe kemi ofertuar me çmim ma te lirë ,ju ne harmoni me vendimin e OSHP te theksuar ma lart keni kerkuar sqarime, ne me kenaqesi ju kemi dhene sqarime.

Prandaj konsideroj se me te drejte jemi duke kerkuar me rishqyrtua vendimin tuaj dhe oferten tone me trajtua ne menyre te barabart dhe me ba rivleresim te drejte te dokumenteve dhe sqarimeve te ofruara te dates 27.05.2025 dhe dokumenteve qe do ti ngarkojme me kete kerkese per Rishqyrtim.

Siq u permed ma lart kjo menyre e trajtimit ne një aktivitet prokurimit Publik eshte diskriminuese dhe ne kundërshtim te plote me nenet si: 1,6 dhe 7 „59 dhe 69 LPP-se dhe te gjitha dispozitat e theksuara ma lart te legjislacionit primar dhe sekondar qe rregullojn ket e fushë.

Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së ku dihet se qellimi i ketij neni nder te tjera është te sigurojë menyre me efikase ,me transparente dhe me te drejte të shfrytzimit të fondeve publike ,duke percaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen ,procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te permbushen nga personat, operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese .

Ne siq e sqaruam më lart jemi ofertues që i plotsojm te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe me DT dhe kemi ofertuar me çmim **rreth 11,930.00 € ma i lirë** se OE i rekomanduar për kontratë dhe jemi eliminuar , krejt ne kundërshtim me qellimin e nenit 1 të LPP-së .

**Pretendimi nr.2**

Ne vendimin e dates 15.07.2025 keni marrur vendim per shperblim me kontratë per OE Te Fatosi SHPK e cila eshte e papergjegjshme ne kete aktivitet te prokurimit per shkak se nuk ka bere zgjatje te Validitetit te Ofertes e po ashtu nuk ka bere Vazhdim te Sigurimit te Tenderit.

Me daten 10.06.2025 dhe me daten 16.07.2025 ne kemi patur qasje ne dokumente zyrtare ku ju si zyre e prokurimit na keni dhene qasje dhe gjate ekzaminimit te dokumentacionit shihet se validiteti i Ofertes ka qene 120 dite nga data 14.10.2024 deri me date **11.02.2025** ndersa OE "Te Fatosi SHPK" nuk e ka vazhduar validitetin e ofertes ne kobe, por ka bere sqarim se vazhdon validitetin e ofertes nga data 20.05.2025. Do te thote sa ka shkeputje te validitetit te Ofertes **prej 11.02.2025 deri me 20.05.2025 total: 99 dite**, e qe kjo eshte ne kundërshtim te plote me ligjin mbi Prokurimin Publik dhe nenin Neni 30 Validiteti i Tenderit e qe nderlidhet direkt me nenin 97 te Rregullores nr 001/2022 per prokurim publik versioni i konsoliduar ,po i permendi vetem nenet qe besoj se per zyrtarin pergjegjes te prokurimit jane te kuptueshme pa dashur te shtergarkoje kerkesen edhe me pasojat qe nderlidhen me keto shkelje,duke shpresuar se te njejtat shkelje do te eliminohen me rastin e shqyrtimit te kesaj kerkese ,pasi qe ne si ofertues i pergjegjeshem me çmim ma te lirë e kemi vazhduar valeditetin dhe sigurimin e tenderit me kobe pa ndërprerje.

Po ashtu gjate ekzaminimit te dokumentacionit verehet se sigurimi i tenderit ka qene me afat nga **14.10.2024 deri me date 13.03.2025** ndersa OE i shpallur fitues "Te Fatosi SHPK" ka bere Sigurim

te Tenderit nga data 19.05.2025 qe do te thote se ka shikeputje te Sigurimit te Tenderit nga data 13.03.2025 deri me date 19.05.2025 total:68 dite, do te thote se nuk ka bere vazhdim te sigurimit te tenderit, e qe kjo eshte ne kundërshtim te plote me ligjin mbi Prokurimin Publik perkatsisht nenin 57 dhe nenin Neni 28 Sigurimi i Tenderit dhe nenin Neni 30 Validiteti i Tenderit e qe nderlidhet direct me nenin 97 te Rregullores nr 001/2022 per prokurim publik versioni i konsoliduar dhe UDHEZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHEZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, neni 10, Sqarimi i tenderëve gjate procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

*Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT*

*Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm*

57

Ne si Agribau edhe ne kerkese per rishqyrtim te dates 16.06.2025 kemi potencuar te njejtin pretendim lidhur me Validitetin e Ofertes, mirpo ju si AK nuk e keni marru per baze dhe nuk keni dhene sqarime lidhur me kete pretendim. Edhe pse ju veq jeni njoftuar ne ate kerkese lidhur me validitetin e ofertes dhe sigurimin e tenderit te skaduar prape se prape keni vendosur qe te shperbleni me kontrate OE Te Fatosi SHPK e cila eshte e papergjegjshme.

*Vendnje: Riperserisim edhe njeher se ka me dhjetra e dhjetra qe mos te them qindra raste vendime te OSHP-se qe i kanë aprovuar ankesat per qeshtjen e mos vazhdim te sigurimit dhe validitetit te tenderit andaj i njejt rast edhe mund te trajtohet si qeshte e glykuar res-judikata (pa dashur ne kete rast ti permendi secilin vendim)*

*AK nese do ta bente vleresimin e drejte ne do duhet te shpalleni fitues, por perveq shkeljeve per kompanin tone i njejt e ka favorizuar OE e shpallur fitues ne tri menyra si:*

1. Pa e vertetuar certifikaten iso standard pa marr konfirmim e ka shpallur fitues edhe pse ka kerkua sqarim por pa pranua konfirmim e ka shpallur fitues.
2. Pa sigurim te tenderit e ka shpallur fitues.
3. Pa valeditet te tenderit e ka shpallur fitues.

### **Pretendimi nr.3**

Gjate ekzaminimit te dokumentacionit ne te cilin kemi patur qasje si me daten 10.06.2025 poashtu edhe me daten 16.07.2025, verehet se keni kerkuar verifikimin e Certifikatave ISO per te dy OE-te mirpo konfirmimin Pozitiv keni marrur vetem per OE Agribau SHPK nga Kompania certifikuese "Sistema Certifications & Inspections Pvt. Ltd.

E Perserisim prap ne kete kerkese se, Ju si AK keni bere kerkese per verifikim tek kompania e njejte Sistema Certifications & Inspections Pvt. Ltd. edhe per certifikaten e kompanise Te Fatosi SHPK e cila nuk eshte leshues i Certifikates per kete kompani, sepse Certifikata e kompanise "Te Fatosi SHPK" eshte e leshuar nga kompani tjeter (Bureau Veritas Certification) me qe rast nuk keni marrur pergjigje pozitive nga kjo kompani, por keni perdorur si arsyetim pergjigjen e dhene nga Kompania certifikuese "Sistema Certifications & Inspections Pvt. Ltd. per Agribau SHPK. Certifikata ISO e dorezuar nga OE Te Fatosi SHPK eshte certifikate e leshuar nga kompania (Bureau Veritas Certification) dhe linku per verifikim i kesaj kompanie eshte i ndryshem me kompanine qe ka leshuar certifikaten per Agribau SHPK.

Ne kemi tentuar te bejme verifikimin e kesaj certifikate permes linkut per verifikim te kompanise (Bureau Veritas Certification) mirpo ky link nuk e njeh kete nr. certifikate, eshte i panjohur. (shih verifikimin te cilin ne kemi bere).

Kjo certifikate nuk mund te verifikohet dhe eshte e dyshimt se eshte e falsifikuar, prandaj AK do te duhet te kerkoje zyrtarisht verifikimin dhe linkun per kete certifikate.

Kerkojme nga AK qe te behet verifikimi i kesaj certifikate dhe te kerkoj nga Organet kompentente marrjen e masave ne rast se kjo certifikate eshte e falsifikuar, per shkak se kompania ne fjale veq se ka marrur tender dhe ka nenshkruar kontrate duke perdorur nje certifikate te dyshimt.

Ky eshte manipulim me deshmite se gjoja ju si AK keni bere verifikim te Certifikates ISO te

kompanise "Te Fatosi SHPK", dhe gjat qasjes ne dokumente na keni ofnuar per verifikim konfirmimin per kompanin tone dhe te neserme na kam kerkua edhe permes emailit konfirmimin per OE te shpallur fitues po deri me tani nuk na e keni dorezuar asnje deshimi se eshte bere verifikimi.

Po ashtu gjate qasjes ne dokumente te dates 16.07.2025 verehet se nuk ka pasur asnje komunikim nga AK me OE "Te Fatosi SHPK" per te kerkuar ta dergoi linkun zyrtar per verifikim te kesaj Certifikate, e poashtu nuk ka pasur asnje komunikim asnjeher ne mes te AK-se dhe kompanise certifikuese (Bureau Veritas Certification).

Edhe ne vendimin e OSHP-se Paneli shqyrtues ka kerkuar decidivisht verifikimin e certifikates ISO per OE Te Fatosi SHPK e shpallur fitues. (me poshte shih kerkese e Panelit Shqyrtues)

Lidhur me pretendimin nr 3 sipas ankesës ku eshte theñe se pas kthimit ne ri-vlersim me datën 18.11.2024 keni kerkuar sqarime per dy pretendimet ankimore nr 1 lidhur me certifikatën ISO 9001:2025. dhe nr 2 marrveshjen me ATK-ne. ndërsa nga ana tjetër gjate këtij aktiviteti per Lot 2 keni marur vendim per shpërblim me kontrate per OE Te Fatos per te cilën nuk keni kerkuar asnjë verifim te certifikatës ISO.

Panel Shqyrtues kërkon nga AK ja qe gjate rivlerësimit të bëjë verifikimin e ISO certifikatës.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Njoftimin për Kontratë si dhe te gjeturave konform vendimit të kërkesës për rishqyrtim konstaton si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: "Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI-LOTO I".

Komisioni i Rivlerësimit konform kompetencave ligjore i ka shqyrtuar dhe ka analizuar te gjitha shkresat, vendimet dhe ofertat për këtë aktivitet te prokurimit:

1. Vendimin e OSHP: 2025/0020 lidhur me ankesën e datës 06.01.2025 te paraqitur ankese ne OSHP nga OE AGRI BAU SH.P.K kundër njoftimit te AK-së te datës 27.12.2024 për dhënie te kon kontratës dhe vendimit nga ZPP te datës 18.06.2025 i miratuar pjesërisht sipas pikës 1 te vendimit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI-LOTO I".

2. Kërkesat mbi sqarimet e kërkuara nga komisioni për Rivlerësim i datës 23.04.2025 për ISO standardet dhe kompanitë ofertuese dhe sipas vendimit te OSHP: 2025/0020, për Certifikata ISO – 9001:2015, Komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE-ik Agribau me 19.11.2024 dhe OE-ik është përgjigjur sqarimeve ku ka dorëzuar kopjen e Certifikatës. Komisioni i rivlerësimit me datë 27.11.2024 i ka kërkuar sqarim edhe Kompanisë e cila ka lëshuar këtë Certifikatë ISO si me poshtë:

From: Prokurimi Prishtine

Sent: 27 November, 2024 16:59

To: 'sistemacerts@gmail.com' <sistemacerts@gmail.com>

Cc: Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>; Kreshnik Smajli <Kreshnik.Smajli@rks-gov.net>

Subject: Request for information regarding ISO 9001-2015

Dear SISTEMA,

To Whom It May Concern,

We are writing you on behalf of the Pristina municipality – Capital of the Republic of Kosovo. We are currently ongoing a procurement procedure "Decorations for summer, winter and important dates" with no. 616-24-8967-2-1-1. One of the participants in this procedure is also "Agribau Sh.P.K." from Pristina address "Zona industriale amortizatorët".

Among the documents this participant "Agribau Sh.P.K." has presented to us is also the certificate ISO 9001:2015 – quality management system valid for the activities "wholesale of decorative lights, agricultural machinery, equipment and supply parts" with certificate no. AGS/2311/QSCIPL-KOS-Q5368 initially issued on 25.11.2022 and with issue date on 14.11.2023.

Regarding this ISO certificate, we would really appreciate it if you will answer the following questions:

1. Can you confirm that the certificate mentioned above and attached to this email is identical with the certificate that you have issued for "Agribau Sh.P.K."? If yes, please confirm but if not, please explain the differences?

2. If you have issued the certificate mentioned above, can you confirm if there are any changes regarding the ISO standard 9001:2015 or if you have imposed any changes on the certificate after the issue date for "Agribau Sh.P.K."? If yes, please explain the changes?

We thank you in advance and really appreciate if you would consider answering us as soon as possible. Thank you very much.

All the best, With great respect:

Procurement Sector Municipality of Pristina - Republic of Kosovo

Autoriteti Kontraktues ka pranuar përgjigjen nga kjo kompani me datë: 04.12.2024 si në vijim:

Hello Visar

Yes the copy of the certificate is issued by us, and surveillance is undergoing.

Thanks

Engr Aman

Komisioni i Rivlerësimit ka kërkuar sqarime shpesh OE-ik "Agribau" edhe ne lidhje me Vërtetimet tatimore konkretisht për marrëveshjen me ATK-ne për shlyerjen e obligimeve si dhe dëshmitë për pagesa. OE-ik Agribau është përgjigjur dhe ka dorëzuar dokumentacionin sipas kërkesës dhe komisioni për këtë pike konstaton se sqarimet janë te pranueshme.

Komisioni i rivlerësimit për piken kontestimore ne kërkesën për rishqyrtim ne lidhje me pajisjet e dorëzuara me oferte nga OE-ik "Agribau" konstaton se OE-ik "Agribau" nuk ka dorëzuar dëshmitë e pajisjeve konform kërkesës se DT-së dhe njoftimit për kontrate kjo pike e gjykuar nga vendimi i OSHP-së 2025/0020 lidhur me ankesën e datës 06.01.2025 te paraqitur ankese ne OSHP nga OE AGRI BAU SH.P.K kundër njoftimit te AK-së te datës 27.12.2024.

Komisioni i Rivlerësimit nuk e ka trajtuar sepse për këtë pike ka vendos organi i shkalles se dyte OSHP te cilin po bashkëngjisim si ne vijim:



**- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -**

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE MË RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar për faktin se lidhur me pretendimin nr 1 per

paisjet e ofruar te kërkuara nga AK-ja ne sipas DT dhe NJK , tek III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ku jane kerkuar : tabilimetet dhe pajisjet teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit ; **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** Dy Shporta ngritese per montim te ndricimit dhe dekorimeve. 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrveshjet per shfrytezimin e tyre Dy Shporta ngritese per montim te ndricimit dhe dekorimeve. 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrveshjet per shfrytezimin e tyre. Gjate egzaminimit te ofertes per cka është eliminuar edhe OE ankues është ofruar marrveshje sipas dates: 01.06.2022, ku OE angazhon OE BLINI CLEANEN per kryerjen e puneve pa specifikuar ndonje titull te aktivitetit apo nr te prokurimit, dhe se kontrata e till i bije te jetë nënkontraktues ngase ne nenin 11 te kësaj kontrate precizohet **" Periudha e kësaj kontrate eshte 3 vjeqare nga data e nënshkrimit te kontratës me mundësi vazhdimi , ndërsa çmimi per pune llogaritet ne ore /pune 20 euro/ h ose varesishte prej punëve dhe specifikave ne pune ku per qdo angazhim ne pune te caktuar do te behet caktimi i pagës sipas marrveshjes per kryerje te asaj pune "** mbarim citati , dhe AK-ja me te drejte ka zbatuar nenin 60 te LPP-se , ndërsa lidhur me librezat e qarkullimit e ofruara Kamionet korpe me dy dyer ne pronësi te ANEA GROUP , ku gjate sqarimeve është ofruar marrveshjen e datës :01.08.2024 ku ANEA GROUP është angazhuar per kryerjen e shërbimeve , ndërsa ne kontratën e me hërshme me nr 616-22-5024-2-2-1 te lidhur me K.Prishtinës sipas dates : **20.07.2022** figuron si **Grup i Operatorëve Ekonomik**, ndërsa në këtë procedur OE ankues ka hyrë si i vetëm dhe se kontrata - marrveshja e ofruar me ANEA GROUP ku citohet se eshte kompani me pron te përbashkët dhe drejtorin e kompanis dhe pjes e familjes te pronarve te dy kompanive kjo kontrate është ne emër te biznesit **" ANEA GROUP "** në këtë rast konsiderohet nënkontraktim sikurse përcaktohet në Neni 30 të LPP-së ku citohet **" Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Një indikator i tillë nuk ka efekt mbi detyrimin kontraktual nga tenderuesi në lidhje me autoritetin kontraktues apo të tjerët. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë, ku ata e konsiderojnë atë si te nevojshme, për pagesat direkte për nënkontraktorët "**, gjë që në oferten e OE ankues mungon informacioni mbi kontraktimin. Ashtu siq përcaktohet ne RrPP neni 17.19 , si dhe në Dosjen e Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit ku tek informacionet citohet :

|                 |      |                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-----------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nënkontraktimet | 12.1 | a. një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit; dheb. Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. |
|-----------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Në këtë rast Paneli Shqyrtues shpjegon se OE ankues nuk ka paraqitur nënkontraktimin sipas LPP-se dhe RrPP-se duke mos ofruar dëshmit sipas dëshmiave të kërkuara a dhe b. Lidhur me

Komisioni i rivlerësimit e konsideron si te papërgjegjshme ofertën e OE-ik "Agribau" SH.P.K dhe e eliminon nga ky aktivitet i prokurimit pasi nuk ka arritur te dorëzoj dokumentacionin sipas kërkesës se DT-se dhe Njoftimit për kontrate për piken 3 për pajisjet .

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se komisioni vlerësues me të drejtë ka konstatuar se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe ky fakt si i tillë është konfirmuar edhe nga Paneli Shqyrtues përmes vendimit të OSHP: 2025/0020 të dt. 06.01.2025. Nga ky këndvështrim është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për arsyet si në vijim:

pajisjet e ofruar te kërkuara nga AK-ja ne sipas DT dhe NJK , tek III.2.4) Kapacitetin teknik dhe profesional ku jane kerkuar : tabilimetet dhe pajisjet teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit ; **Dëshmia e kërkuar dokumentare.** Dy Shporta ngritese per montim te ndricimit dhe dekorimeve. 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrveshjet per shfrytezimin e tyre Dy Shporta ngritese per montim te ndricimit dhe dekorimeve. 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrveshjet per shfrytezimin e tyre. Gjate egzaminimit te ofertes per cka eshte eliminuar edhe OE ankues eshte ofruar marrveshje sipas dates: 01.06.2022, ku OE angazhon OE BLINI CLEANEN per kryerjen e puneve pa specifikuar ndonje titull te aktivitetit apo nr te prokurimit, dhe se kontrata e till i bje te jetë nënkontraktues ngase ne nenin II te kësaj kontrate precizohet **" Periudha e kësaj kontrate eshte 3 vjeqare nga data e nënshkrimit te kontratës me mundësi vazhdimi , ndërsa çmimi per pune llogaritet ne ore /pune 20 euro/ h ose varesisht prej punëve dhe specifikave ne pune ku per qdo angazhim ne pune te caktuar do te behet caktimi i pagës sipas marrveshjes per kryerje te asaj pune "** mbarim citati . dhe AK-ja me te drejte ka zbatuar nenin 60 te LPP-se , ndërsa lidhur me librezat e qarkullimit e ofruara Kamionet korpe me dy dyer ne pronësi te ANEA GROUP , ku gjate sqarimeve eshte ofruar marrveshjen e datës :01.08.2024 ku ANEA GROUP eshte angazhuar per kryerjen e shërbimeve , ndërsa ne kontratën e me hërshme me nr 616-22-5024-2-2-1 te lidhur me K.Prishtinës sipas dates : **20.07.2022** figuron si **Grup i Operatorëve Ekonomik**, ndërsa në këtë procedur OE ankues ka hyrë si i vetëm dhe se kontrata - marrveshja e ofruar nie ANEA GROUP ku citohet se eshte kompani me pron te përbashkët dhe drejtorin e kompanis dhe pjes e familjes te pronarve te dy kompanive kjo kontrate eshte ne emër te biznesit **" ANEA GROUP "** ne këtë rast konsiderohet nënkontraktim sikurse përcaktohet në Nenin 30 te LPP-së ku citohet **" Tenderuesi duhet te tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës qe ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Një indikator i tillë nuk ka efekt mbi detyrimin kontraktual nga tenderuesi në lidhje me autoritetin kontraktues apo të tjerët. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë, ku ata e konsiderojnë atë si te nevojshme, për pagesat direkte për nënkontraktorët "** gjë që në oferten e OE ankues mungon informacioni mbi kontraktimin. Ashtu siq përcaktohet ne RrPP nenin 17.19 , si dhe në Dosjen e Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit ku tek informacionet citohet :

|                 |      |                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-----------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nënkontraktimet | 12.1 | a. <b>një deklaratë</b> ku deklarohen nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit; dheb. Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siq është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. |
|-----------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Në këtë rast Paneli Shqyrtues shpjegon se OE ankues nuk ka paraqitur nënkontraktimin sipas LPP-se dhe RrPP-së duke mos ofruar dëshmit sipas dëshmiave te kërkuara a dhe b. Lidhur me

Komisioni i rivlerësimit e konsideron si te papërgjegjshme ofertën e OE-ik "Agribau" SH.P.K dhe e eliminon nga ky aktivitet i prokurimit pasi nuk ka arritur te dorëzoj dokumentacionin sipas kërkesës se DT-se dhe Njofimit për kontrate për piken 3 për pajisjet .

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.07.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.